



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2023/0257

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetarja e Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP), në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (LPP) në përbërje nga Vedat Poterqoi - Kryetar, Vjosa Gradinaj Mexhuani - Anëtare dhe Agon Ramadani - Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së Operatorit Ekonomik (OE) Sodex Group SH.P.K., kundër Vendimin për dhënie të një kontratë ose të një konkursi të projektimit të POLICIA E KOSOVËS në cilësinë e Autoritetit Kontraktues (AK) lidhur me aktivitetin e prokurimit FURNIZIM ME ANTIPLUMBA me numër të prokurimit 214-21-3387-1-1-1, me 18/08/2023, mori:

Vendim

1. Aprovohet, si pjesërisht e bazuar ankesa e operatorit ekonomik “Sodex Group” SH.P.K. , e parashtruar në Organin Shqyrtues të Prokurimit me 05.05.2023 (me numër protokoll 257/23) për aktivitetin e prokurimit me titull: “Furnizim me Antiplumba “ me nr. të prokurimit: "214-21-3387-1-1-1", iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Policia e Kosoves.

2. Të anulohet në tërësi aktiviteti i prokurimit me titull: “Furnizim me Antiplumba “ me nr. të prokurimit: "214-21-3387-1-1-1", iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Policia e Kosoves.

3. Lejohet kthimi i shumës së deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës dhe obligohet operatori ekonomik ankesues që konform nenit 31 pika 6 të Rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale –

Me 09.06.2021, Policia e Kosoves, në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar njoftimin për kontratë për aktivitetin e prokurimit me titull: “Furnizim me Antiplumba” me nr. të prokurimit: "214-21-3387-1-1-1". Nderkaq me datën 16.12.2021 është publikuar njoftimi mbi vendimin e AK.

OE “Sodex Group” SH.P.K me datën 25.04.2023 ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim në AK.

Me datën 28.04.2023, AK- Policia e Kosoves me vendim ka refuzuar kërkesën për rishqyrtim të OE “Sodex”Group SH.P.K. lidhur me aktivitetin e prokurimit “Furnizim me Antiplumba” me numër të prokurimit 214-21-3387-1-1-1 inicuar nga OE

ankues “Sodex Group” SH.P.K.

AK në vendim ka kërkuar të mbetet në fuqi njoftimi mbi vendimin për dhënie të AK – Policia e Kosoves lidhur me aktivitetin e prokurimit “Furnizim me Antiplumba” me numër të prokurimit 214-21-3387-1-1-1.

I pakënaqur me vendimin e AK-së, OE ankues “Sodex Group” SH.P.K me datën 05.05.2023 ka parashtruar ankesë në OSHP, me numër të protokollit 257/23, kundër vendimit të Autoritetit Kontraktues lidhur me aktivitetin e prokurimit të përshkruar si më sipër.

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës: furnizim, vlera e parashikuar e kontratës: 3,799,800,00 €.

Ankesa e OE është ushtruar në pajtim me nenin 109.1, të LPP, sipas të cilit kundër çdo vendimi të marrë nga AK çdo palë e interesuar mund të parashtrorë ankesë pranë OSHP. Meqë OE ka ushtruar po ashtu kërkesë për rishqyrtim, do të thotë se veprimet e të njëjtit i referohen po ashtu dhe nenit 108/A të Ligjit të cituar. Prandaj OSHP konsideron se Ankesa i plotëson kushtet e parapara në kuptim të dispozitave tani më të cituara dhe e njëjta bie nën kompetencat e tij në kuptim të nenit 105, të LPP.

Në fazën e shqyrtimit paraprak,

(a) OSHP ka konstatuar se ankesa në rastin konkret është ushtruar në pajtim me nenin 109.1 të LPP, sipas të cilit kundër çdo vendimi të marrë nga AK, çdo palë e interesuar mund të parashtrorë ankesë pas zbatimit të procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve, sikurse parashihet me nenin 108/A të këtij ligji. Meqë ankuesi ka statusin e palës së interesuar sikurse përkufizohet me nenin 105, paragrafi 1, lidhur me nenin 4, paragrafi 1.26 të LPP, kurse ankesa përmban elementet qenësore të parapara me nenin 111, të Ligjit të cituar, që do të thotë se e njëjta i plotëson kushtet në kuptim të dispozitave të cituara dhe bijën nën kompetencat e këtij organi në kuptim të nenit 105, të LPP, lidhur me nenin 9, të Rregullores për Punën e OSHP.

(b) Bazuar në veprimet e përshkruara si më sipër, OSHP ka caktuar Panelin Shqyrtues sipas nenit 111, paragrafi 5 (ii) të LPP dhe ka angazhuar ekspertin shqyrtues në pajtim me nenin 111, paragrafi 5 (i) të LPP, me detyrë që i njëjti ta bëjë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve ankimore, përkritazi me këtë aktivitet të prokurimit, në kuptim të nenit 113 dhe 114 të LPP lidhur me nenin 17 dhe 19 të Rregullores së cituar. Lidhur me këtë, me 31.05.2023, eksperti shqyrtues ka dorëzuar Raportin e vlerësimit me rekomandimet si në vijim:

Të aprovohet si pjesërisht e bazuar ankesa e OE ankues.

Të anulohet Vendimin i AK për dhënie dhe lënda të kthehet në rivlerësim.

(c) Paneli konsideron se Raporti i ekspertizës i përmban elementet qenësore sikurse kërkohet me nenin 113, paragrafi 3 të LPP dhe i njëjti është pranuar nga të gjitha palët, sikurse parashihet në kuptim të nenit 115 të LPP lidhur me nenin 20 të Rregullores së cituar. Njëherësh konstatohet se AK ka deklaruar, se nuk pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues, po ashtu dhe OE ankues. ka deklaruar se eksperti shqyrtues nuk ka bërë shqyrtimin e pretendimeve ankimore. Në vijim të kësaj procedure po ashtu konstatohet se palët janë të informuara lidhur me të gjitha shkresat kësaj lënde (nga platforma e prokurimit elektronik) sikurse kërkohet me paragrafin 2, të nenit 20 të kësaj Rregulloreje prandaj janë kushtet (prezumimet) që lidhur me çështjen në rastin konkret, të vendoset në mënyrë meritore.

(d) Paneli konstatoi më tej se nuk ekzistojnë elementet për parandalim të konfliktit të interesit, sikurse kërkohet në kuptim të nenit 11 të Rregullores për Punën e OSHP, prandaj analizoi në vijim të gjitha shkresat e kësaj lënde, përfshirë të gjitha aktet dhe veprimet e palëve dhe konsideroi se ka nevojë të caktohet seanca publike me palë mbajtur me 09.10.2023 sikurse parashihet me paragrafin 2, të nenit 24 të Rregullores së cituar, me qëllim të shqyrtimit objektiv dhe të drejtë të çështjes. Në këtë rast (në zbatim të parimit kontradiktor) janë analizuar pretendimet ankimore, veprimet dhe aktet e AK, përfshirë dhe shpjegimet e ekspertit shqyrtues dhe të gjitha krahas administrimit të gjithmbarshëm të provave, janë prezantuar shkurtimisht në vijim të këtij arsytimi.

- Administrimi dhe vlerësimi i provave -

Me rastin e administrimit të gjitha shkresave të kësaj lënde, analizimit dhe vlerësimit të tyre, Paneli konstatoi se AK ka zbatuar procedurë të hapur (sikurse parashihet me nenin 32 dhe 33 të LPP), lloji i kontratës: furnizim, vlera e parashikuar e kontratës: 3.799 800,00 € (sikurse parashihet me nenin 9, paragrafi 1, lidhur me nenin 15, paragrafi 2, të LPP) veçoi paraprakisht çështjet si në vijim:

AK e ka rekomanduar për kontratë OE PRICOM SHPK; Seyntex NV;

Ankuesi OE “Sodex Group” SH.P.K, ka atakuar Vendimin për dhënie të kontratës të këtij aktiviteti të prokurimit me arsytimin se, Vendimi i atakuar i AK është marrë në kundërshtim me dispozitat e LPP.

Në këtë rast, Paneli mori në konsideratë të gjitha faktet dhe provat të cilat trajtohen si të tilla nga pohimet e ankimore, aktet dhe veprimet e AK dhe duke u bazuar posaçërisht në analizat e ekspertit shqyrtues, i specifikoi në ato më relevante, sikurse vijon:

Pohimet ankimore të OE “Sodex Group” SH.P.K

Ankuesi ka atakuar vendimin e cituar si më sipër me pohimin se AK e ka shkelur dispozitën e nenit 1, të LPP, sepse përderisa ankuesi e ka ofruar ofertën konform kërkesave të DT, do të thotë se (sipas tij/sajë) nga mos shpallja fitues i kontratës nga ky aspekt, përbën keqpërdorim të buxhetit nga ana e AK. Ankuesi ka sqaruar me pohimin se në fillim të këtij aktiviteti të prokurimit me dt. 16.12.2021 përmes platformës elektronike e-prokurimi jemi njoftuar me njoftimin mbi vendimin e AK-së ku, OE “Sodex Group” SH.P.K është rekomanduar për kontratë, ndërsa me dt.22.08.2022, AK ka nxjerr vendimin për anulimin e aktivitetit të prokurimit duke u thirr në një vendim të OSHP-së, nr.880-881/21, 01/22 i dt.28.07.2022.

Kundër vendimit për anulimin e aktivitetit të prokurimit OE “Sodex Group” SH.P.K ka parashtruar ankesë në OSHP, ku e njëjta ishte aprovuar si e bazuar nga ana e panelit shqyrtues me vendimin nr.429-448/22 të dt.21.11.2022, vendimi cili e ka detyruar AK-në të anuloi njoftimin për anulimin e aktivitetit të prokurimit dhe lëndën ta kthej në rivlerësim, për shkak të mos arsyeshmërisë konform nenit 62 të LPP.

Pasi është kthyer lënda në rivlerësim, AK me dt.20.04.2023 ka publikuar njoftimin mbi vendimin e AK-së, ku ka rekomanduar për kontratë grupin e OE PRICOM SH.P.K. & Seyntex NV, ndërsa OE “Sodex Group” SH.P.K është eliminuar me arsyetimin se: Lidhur me arsyen e parë të eliminimit, ju sqarojmë se gjatë qasjes në dokumente që ne kemi pasur edhe tek raporti i vlerësimit dhe në letrën standarde keni konstatuar se OE Sodex ne artikullin 2 e tejkalon peshën e kërkuar duke u bazuar në certifikatën e kalibrimit të vages që e ka përdorur për matje.

Si rrjedhojë, Ankuesi ka atakuar vendimin e cituar si më sipër me pohimin se AK e ka shkelur dispozitat e nenit 1,7,56.3,59,60 dhe 69 të LPP, sepse përderisa ankuesi e ka ofruar ofertën konform kërkesave të DT, do të thotë se (sipas tij/sajë) vendimi I AK-së është në kundërshtim me dispozitat e lartëcekura. Më tej ankuesi ka pohuar se sipas AK-së matja ka rezultuar me 8.04kg, që d.m.th. sipas vagës, pesha e tejkalon maksimumin për 40 gram. Duam të ju informojmë se kjo rezulton me një devijim minimal prej 0,5% të peshës së cekur dhe duam të ju informojmë se edhe certifikata e kalibrimit të vages së AK-së e ka shënimin ku thotë se probabiliteti i mbulimit përafërsisht 95% që d.m.th. se ka një tolerancë prej 5% në matje. Pra pesha e jelekut sipas vagës së AK-së është 0.5% më e lartë se kërkesa e AK-së ndërsa tolerancë prej 5% konfirmon se pesha është brenda masës së tolerancës së lejuar. Ju e kemi cekur si sqarim, se pas kalibrimit të peshores në 8 kg duhet shtuar edhe 30g, mirëpo për ne është e panjohur se si keni ardh në një përfundim të tillë dhe se përse duhet të shtohen 30 g peshores. Ky sqarim i juaji për mendimin tonë nuk është profesional pasi që peshorja duhet të kalibrohet dhe nuk ka nevojë që të shtohen gram fare. Me këtë sqarim që keni bërë po shihet qartë se peshimi nuk është bërë në mënyrë profesionale. Megjithatë fakti i lartcekur përbën devijim të vogël që nuk mund të shkaktojë ndryshime materiale ose devijime nga karakteristikat, kushtet, dhe kërkesat e tjera të parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit dhe ky devijim parashihet të neni 59.4 pika (ii).

Lidhur me arsyen e dytë të eliminimit, për neve është shumë e paqartë se çka keni nënkuptuar me pretendimin se mostra nuk e ka pjesën mbrapa ijëve, sepse ne i kemi ofruar mostrat sipas specifikimeve teknike të kërkuara. Sa i përket termit që ju kemi përdorur se mostrës i mungon pjesa mbrapa ijëve ju sqarojmë se në fjalorin e gjuhës shqipe fjala ije nënkupton si në vijim:

1. Ana e djathtë ose ana e majtë e trupit të njeriut a të kafshëve midis brinjëve dhe kërdhokullës; ana e djathtë ose ana e majtë e mesit. Ija e majtë (e djathtë). Ijë më ijë nga njëra ijë në tjetrën. Gropat e ijëve. Stil në ijë. sport. stil noti që bëhet i kthyer në brinjë. Më dhembin ijët. I ra në ijë.

Kthehem (shtrihem, fle) në ijë. Vë duart në ijë. Ngjesh në ijë. 2. Ana e djathtë ose e majtë e dikujt a e diçkaje; anë, qenar i një sendi; krah. Ijët e anijes. Ija e malit (e qytetit). E sulmoi armikun në ijë. I doli nga ija e majtë (e djathtë). I mori ijët i mori krahët.

Po ashtu, OE ankues potencon faktin se AK ka rekomanduar për kontratë një OE i cili është i papërgjegjshëm për arsyet si në vijim:

Ne specifikacionet teknike është kërkuar që jeleku të jetë nga Soft Protection Level NIJIIIA (3A) – Ballistic Protection (.44 Magnum 240 / JHP). I njëjti nuk e plotëson kërkesën e lartcekur për faktin se Atestet e dorëzuara për model VAR 5 (artikulli 1) janë të performancës SJHP (Semi-Jacketed Holoë Point) dhe jo JHP (Jacketed Holoë Point) siç është kërkuar ne DT. Gjithashtu edhe ne katalogun e ofruar për vlerësim është potencuar SJHP.

Mbrojtja e ofruar balistike për pjesën e butë balistike nuk është në përputhje me kërkesën e AK-së për mbrojtje balistike dhe si e tillë nuk i plotëson kërkesat e dosjes së tenderit dhe Specifikat teknike.

Ne specifikacionet teknike është kërkuar që jeleku të jetë nga Soft Protection Level NIJIIIA (3A) – Ballistic Protection (.44 Magnum 240 / JHP) AK është munduar që ta sqaroj këtë pike duke kontaktuar me Laboratorin me email disa herë.

AK me date 27.01.2023 ka kërkuar nga laboratorit klarifikim për SJHP (SemiJacketed Holoë Point) dhe JHP (Jacketed Holoë Point) por nuk ka marr fare përgjigje nga laboratorit. Një përgjigje ne emër te laboratorit e ka dorëzuar vetëm OE Pricom.

AK me date 22.02.2023 nga laboratorit ka kërkuar konfirmim nëse laboratorit e ka lëshuar atë përgjigje, por nuk e ka ndonjë konfirmim. Një konfirmim tjetër ka ardhur nga Seyntex (ofertues), megjithatë nga Laboratorit testues nuk është pranuar as email e as konfirmim. Ndërsa kërkesa i ishte adresuar Laboratorit dhe jo ofertuesit, konsiderojmë se asnjë përgjigje nuk është pranuar nga Laboratorit dhe si e tillë nuk mund të pranohet për vlerësim. Për më tepër në këtë rast nuk ka pasur nevojë e as arsye të kërkohet sqarime nga laboratorit, sepse dëshmi të tjera nuk pranohen dhe po ashtu nuk pranohen konfirmime të tjera nga asnjë laborator. Dokumentet kanë qenë të qarta dhe mosplotësimi i kërkesave kanë qenë të qarta, prandaj neni 72 nuk është përdorur në mënyrë objektive por është shfrytëzuar në drejtim të favorizimit të OE të rekomanduar për kontratë.

Antiplumb i jashtëm: është kërkuar: Outer shell from water-repellent hard wearing 1000D CORDURA fabric or equivalent, kurse OE i rekomanduar për kontratë nuk ka ofruar specifika për 1000D CORDURA fabric, prandaj ky OE është i papërgjegjshëm. OE i rekomanduar për kontratë përmes klarifikimit e ka konfirmuar që materiali i Cordura te ofruar është 500D. Pra NUK ka ofruar produkt sipas kërkesës se DT ku është kërkuar që Cordura te jete 1000D ose ekuivalente, prandaj 500D përveç se nuk është sipas kërkesës nuk është as ekuivalente.

Tek specifikacionet teknike është kërkuar që pllaka balistike të jetë Ballistic Plates Protection Level NIJ-IV (4) (.30 cal. 166 / M2AP) from polyethylene system or equivalent, this rigid armour insert needs to have incredible ballistic capabilities, as well as excellent multi-hit resistance, kurse Pllaka balistike e ofruar si mostër nga OE i rekomanduar për kontratë është vetëm për një të shtënë (1 Shot), e jo sipas kërkesës së lartcekur.

Fakti i lartcekur mund të vërtetohet edhe nga katalogu i OE të rekomanduar për kontratë, ku ceket si në vijim: “.30-06 APM2 at 878 /- 9 m/s (1 shot)”

Edhe ne raportet testues është potencuar se testimi është bërë vetëm me një të shtënë (1 shot), prandaj është e qartë se OE i rekomanduar për kontratë është i papërgjegjshëm.

Pra mbrojtja e ofruar balistike për pjesën e forte balistike nuk është ne përputhje me kërkesën e AK-se për mbrojtje balistike dhe si e tille nuk plotëson kërkesat e DT dhe Specifikat teknike.

Tek kërkesat mbi mundësitë teknike dhe profesionale është kërkuar qe: d) Operatori Ekonomik duhet të dorëzoj mostra për secilin artikull, më së largu deri ditën e hapjes në ora 14:00.

Jeleku i ofruar si mostër për artikullin 2 nga OE i rekomanduar për kontratë nuk është model i njëjtë me modelin e prezentuar ne katalog. Tek Pyetje-përgjigje për antiplumba te datës 02.07.2021 është specifikuar që: 3D spacer mesh Trashësia duhet te jete 3-5mm

Tek Pyetje-përgjigje për antiplumba te dates 02.07.2021 është specifikuar qe: Ju lutemi te na konfirmoni nëse pllakat balistike me material Alumina / Polyethylene/ Silicon Carbide janë te pranueshme, sigurisht duke ofruar nivelin e kërkuar te mbrojtjes? Kjo për arsye se pllakat Polyethylene /Silicon Carbide nuk ofrojnë peshe me te lehte ne peshën e përgjithshme te Antiplumbit dhe si te tilla ndikojnë ne rritje te çmimit.

Tek specifikacionet teknike është kërkuar që pllaka balistike të jetë Ballistic Plates Protection Level NIJ-IV (4) (.30 cal. 166 / M2AP) from polyethylene system or equivalent, this rigid armour insert needs to have incredible ballistic capabilities, as well as excellent multi-hit resistance, kurse Pllaka balistike e ofruar si mostër nga OE i rekomanduar për kontratë është vetëm për një të shtënë (1 Shot), e jo sipas kërkesës së lartcekur.

Fakti i lartcekur mund të vërtetohet edhe nga katalogu i OE të rekomanduar për kontratë, ku ceket si në vijim: “.30-06 APM2 at 878 /- 9 m/s (1 shot)” Edhe ne raportet testues është potencuar se testimi është bërë vetëm me një të shtënë (1 shot), prandaj është e qartë se OE i rekomanduar për kontratë është i papërgjegjshëm. Pra mbrojtja e ofruar balistike për pjesën e forte balistike nuk është ne përputhje me kërkesën e AK-se për mbrojtje balistike dhe si e tille nuk plotëson kërkesat e DT dhe Specifikat teknike.

Tek kërkesat mbi mundësitë teknike dhe profesionale është kërkuar qe: d) Operatori Ekonomik duhet të dorëzoj mostra për secilin artikull, më së largu deri ditën e hapjes në ora 14:00.

Jeleku i ofruar si mostër për artikullin 2 nga OE i rekomanduar për kontratë nuk është model i njëjtë me modelin e prezentuar ne katalog. Tek Pyetje-përgjigje për antiplumba te datës 02.07.2021 është specifikuar që: 3D spacer mesh Trashësia duhet te jete 3-5mm

Tek Pyetje-përgjigje për antiplumba te dates 02.07.2021 është specifikuar qe: Ju lutemi te na konfirmoni nëse pllakat balistike me material Alumina / Polyethylene/ Silicon Carbide janë te pranueshme, sigurisht duke ofruar nivelin e kërkuar te mbrojtjes?

Sipas specifikimit teknik është e qartë që është kërkuar pllakë SAPI, ndersa pllaka e dorëzuar nga OE është swimmer shih foton me poshte. Kjo pllakë ka mbulueshmeri shumë më të vogël dhe të papërshtatshme për perdorime policore dhe vë në rrezik jetën e përdoruesit duke mos mbuluar organet vitale të policit në detyrë.

Kurse neve na kishit rekomanduar më parë për kontratë, kurse tash na eliminoni. Duke u bazuar në dëshmitë dhe faktet që u cekën më lartë rezulton se ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve nuk është bërë në harmoni me nenin 59 të LPP-së dhe njëkohësisht nuk është respektuar edhe kriteri kryesor për dhënie të kontratës, e që ka qenë tenderi i përgjegjshëm me çmim më të ulët sipas neni 60 paragrafi 1.1 i LPP-së.

Gjithashtu ju nuk e keni respektuar edhe nenin 7 të LPP-së, sepse na keni diskriminuar neve duke mos na shpallur fitues edhe pse i kemi plotësuar të gjitha kërkesat e FTD-së dhe të njoftimit për kontratë. Paragrafi 1 i nenit 7 të LPP-së e parashih qartë që “Autoriteti kontraktues do ti trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jodiskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente”.

Po ashtu ju e keni favorizuar OE e rekomanduar për kontratë duke e shpall fitues edhe pse i njëjti është i papërgjegjshëm, ndërsa anë këtë rast keni rënë ndesh edhe me paragrafin 6 të nenit 7 pika (vi) ku shkruan që Autoriteti kontraktues duhet të sigurohet që tenderi i zgjedhur të përputhet me të gjitha aspektet përmbajtësore të kushteve, kriterëve dhe specifikimeve përkatëse.

Përgjigja 3 Pllakat duhet te ofrojnë mbrojtje balistike ne gjithë hapësirën e saj, sipas test raporteve te kërkuara, përveç pllakës silicon carbid pranohet edhe ekuivalenti, p.sh. Boron Carbide Balstic plates, etj.— Mostra e ofruar per kete artikull nuk e ka meshin 3D siç është kerkuar me DT dhe me sqarimet shtese te datës 02.07.2021, me te cilën sqarohet se 3D spacer mesh duhet te ketë trashësi prej te paktën 3-5mm.

Pllakat e ofertuara jane nga:

Alumina /SiC ceramic

Përkundër sqarimeve shtesë të ofruara me date 02.07.2021 në të cilën informohen operatorët e interesuar ekonomik se pllakat mund të ofrohen edhe me materiale tjera ekuivalente me Silicon Carbide siç është Boron Carbide, por jo edhe pllaka balistike me material nga Alumini, pllakat e ofruara nga OE i rekomanduar për kontratë jane me përmbajtje Alumini, dhe si e tille nuk plotësohen kërkesat e DT dhe Specifikat teknike.

- Konstatimet e Panelit Shqyrtues -

Paneli shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, shqyrtimit të pretendimeve ankimore të OE ankues, konstatimeve, analizës konkrete dhe rekomandimeve të ekspertit shqyrtues, deklarimit të palëve në procedurë diskutimeve dhe shoshitjes së provave në tërësi sqaron se:

Vlenë të theksohet se AK këtë aktivitet të prokurimit e ka filluar më 09.06.2021, i cili që nga inicimi i këtij aktiviteti të prokurimi është përcjellur me disa sqarime dhe përgjigje nga ana e OE dhe AK, po ashtu, para hapjes së këtij aktiviteti të prokurimit edhe me kërkesa për ri-shqyrtim pranë autoritetit kontraktues. Këto kërkesa, AK i refuzon dhe më dt. 13.08.2021 bënë hapjen e këtij aktiviteti të prokurimit dhe pas 2 muajëve vlerësim, më dt. 20.10.2023 bëhet edhe publikimi i njoftimit mbi vendimin e AK (B58) dhe letrat standarde. Me këtë vendim (B58) AK rekomandon për kontratë OE PRICOM SHPK; Seyntex NV, ndërsa, të gjithë OE pjesëmarrës eliminohen nga gara për këtë aktivitet të prokurimit. Të pakënaqur me vendimin e AK të dt. 20.10.2021, 4 (katër) OE pjesëmarrës, përfshirë edhe “Sodex Group” SH.P.K, bëjnë kërkesë për ri-shqyrtim, me çrast AK më 01.11.2021 nxjerrë vendim duke i aprovuar pjesërisht kërkesat për

ri-shqyrtim dhe duke e kthyer lëndën në ri-vlerësim rrjedhimisht anulon njoftimin për dhënie të kontratës. AK më dt. 16.12.2021 nxjerr njoftimin tjetër me radhë (B58) ku rekomandon për kontratë OE “Sodex Group” SH.P.K, dhe eliminon të gjithë OE tjerë pjesëmarrës përfshirë edhe OE PRICOM SHPK; Seyntex NV me 11 arsye për eliminimit bazuar nga komisioni i cili supozohet të jetë profesional nga ana e AK:

Antiplumb I brendshëm

- Testet balistike për pjesët e buta te antiplumbit te brendshëm janë bere me llojin e municionit 44mag.240 SJHP dhe jo me llojin e municionit 44mag. 240 JHP siç është kërkuar.
- Raporti I testimit ne laborator për KR1 I referohet modelit me nr. BP602 ndersa ne katalog është paraqitur modeli XP-UC-01 Classic.

Antiplumb I Jashtëm

- Testet balistike për pjesët e buta te Antiplumbit janë bere me llojin me municionin 44mag.240 SJHP dhe jo me llojin e municionit 44mag. 240 JHP siç është kërkuar.
- Mostra e kërkuar sipas kërkesës për matje ka qene masa “L” ndersa OE për jelekun antiplumb te jashtëm e ka ofruar masën “XL”.

Antiplumb Taktik

- Testet balistike për pjesët e buta te Antiplumbit janë bere me municionin 44mag.240 SJHP dhe jo me llojin e municionit 44mag. 240 JHP siç është kërkuar. Lloji i municionit SJHP me te cilin janë testuar pjesët e buta te jelekëve antiplumb është më pak depërtues se lloji i municionit JHP.
- Mostra e kërkuar sipas kërkesës për matje ka qene masa “L” ndersa OE për jelekun antiplumbin taktik e ka ofruar masën “M”.
- Antiplumbi taktik nuk posedon xhepat anësor për vendosjen e pllakave balistike siç është kërkuar me specifikacione teknike.

- Modeli I testuar sipas testeve balistike për pjesën e bute te antiplumbit niveli IIIA është 3AP482 ndersa modelet e ofruara sipas katalogut janë XP-UC-01 për antiplumbin e brendshëm, OM-1589-136 për antiplumbin e jashtëm dhe MEHLER COMBAT ONE për antiplumbin taktik.
- Ne katalog nuk është paraqitur asnjë fotografi për pllakën balistike përveç shënimeve.
- Mostrat e ofruara nga OE janë te njëjtat me mostrat e testeve laboratorike por nuk janë te njëjtat me katalogun e ofruar.
- Ne katalog OE jelekët antiplumb I ka prezantuar me çanta (Carrying Bag) ndërsa mostrat I ka ofruar me qese tjera te cilat nuk përkojnë me katalog.

Të pakënaqur me vendimin e AK të dt. 16.12.2021, 3 (tre) OE pjesëmarrës, përfshirë edhe OE PRICOM SH.P.K & Seyntex NV, bëjnë kërkesë për ri-shqyrtim, me çrast AK më 24.12.2021 nxjerrë vendim duke i refuzuar kërkesat për ri-shqyrtim. Pas këtij refuzimi të tre OE të cilët kanë bërë kërkesë për ri-shqyrtim në AK, të njëjtit bëjnë ankesë edhe në OSHP. Koha kur OE kanë bërë ankesë në OSHP, bordit paraprak i kishte kaluar mandati ligjore dhe si pasojë e kësaj për një kohë të gjatë mbi 1 vit OSHP ishte pa bord. Me ardhjen e bordit të ri në OSHP, ankesat e deponuara dhe të pazgjdhura i hedhë poshtë si të palejuara të cilat ju është kaluar afati për shqyrtim. Ndërsa me dt.22.08.2022, AK ka nxjerr vendimin për anulimin e aktivitetit të prokurimit duke u thirr në vendim të OSHP-së, nr.880-881/21, 01/22 i dt.28.07.2022, nga përmbajtja e tij, vendim procedural (nënkupto pa sqyrtim të pretendimeve ankimore) edhe pse ka pasur vendim për dhënie të kontratës (B58) dhe me OE të rekomanduar për kontratë OE “Sodex Group” SH.P.K.

Kundër vendimit për anulimin e aktivitetit të prokurimit OE “Sodex Group” SH.P.K si dhe “OE PRICOM SH.P.K & Seyntex NV”, kanë parashtruar ankesë në OSHP, ku të njëjtat ishin aprovuar si të bazuara nga ana e panelit shqyrtues me vendimin nr.429-448/22 të dt.21.11.2022,

vendimi cili e ka detyruar AK që të anuloj njoftimin për anulimin e aktivitetit të prokurimit dhe lëndën ta kthej në rivlerësim, për shkak të mos arsyeshmërisë së anulimit konform nenit 62 të LPP (nga përmbajtja vetëm proceduralisht, pa shqyrtim të pretendimeve ankimore).

Pasi është kthyer lënda në rivlerësim, AK me dt.20.04.2023 ka publikuar njoftimin mbi vendimin e AK-së, ku ka rekomanduar për kontratë grupin e OE PRICOM SH.P.K. & Seyntex NV, ndërsa OE "Sodex Group" SH.P.K është eliminuar me arsyetimin se: Lidhur me arsyen e parë të eliminimit, ju sqarojmë se gjatë qasjes në dokumente që ne kemi pasur edhe tek raporti i vlerësimit dhe në letrën standarde keni konstatuar se OE Sodex ne artikullin 2 e tejkalon peshën e kërkuar duke u bazuar në certifikatën e kalibrimit të vages që e ka përdorur për matje. Si rrjedhojë, Ankuesi ka atakuar vendimin e cituar si më sipër me pohimin se AK e ka shkelur dispozitat e nenit 1,7,56.3,59,60 dhe 69 të LPP.

Ankuesi lidhur me pretendimet ankimore rreth eliminimit të OE ankues që kanë pasur të bëjnë me Matjen e mostrave ku sipas AK, matja ka rezultuar të jetë 8.04 kg, si dhe lidhur me arsyen tjetër të eliminimit se mostrës i mungon pjesa mbrapa ijëve, e mbështet vendimin e atakuar të autoritetit kontraktues sepse janë dhenë shpjegime të drejta po ashtu edhe lidhur me pohimet ankimore. Paneli vëren se arsyet e dhëna në vendimin e atakuar të autoritetit kontraktues janë profesionale dhe të argumentuara pa vërejtje me prova materiale, pa nevojë që të përshkruhen sërish. Ngase OE tek asnjëri pretendim i lartëcekur nuk ka arritur të provojë kundërtën apo të sjellë argument bindës për PSH se eliminimi i tyre ka qenë i pa bazë. Vetëm është thirrur në devijime të vogla dhe të kalibrimit i peshores që për PSH nuk është i mjaftueshëm, ndërsa, sa i përket eliminimit të dytë vetëm ka deklaruar se: *"për neve është shumë e paqartë se çka keni nënkuptuar me pretendimin se mostra nuk e ka pjesën mbrapa ijëve, sepse ne i kemi ofruar mostrat sipas specifikimeve teknike të kërkuara. Sa i përket termit që ju keni përdorur se mostrës i mungon pjesa mbrapa ijëve ju sqarojmë se në fjalorin e gjuhës shqipe fjala ije nënkupton si në vijim: Ana e djathtë ose ana e majtë e trupit të njeriut a të kafshëve midis brinjëve dhe kërdhokullës; ana e djathtë ose ana e majtë e mesit. Ija e majtë (e djathtë). Ijë më ijë nga njëra ijë në tjetrën. Gropat e ijëve. Stil në ijë. sport. stil noti që bëhet i kthyer në brinjë. Më dhembin ijët. I ra në ijë. Kthehem (shtrihem, fle) në ijë. Vë duart në ijë. Ngjesh në ijë. 2. Ana e djathtë ose e majtë e dikujt a e diçkaje; anë, qenar i një sendi; krah. Ijët e anijes. Ija e malit (e qytetit). E sulmoi armikun në ijë. I doli nga ija e majtë (e djathtë). I mori ijët i mori krahët."* Andaj, pala ankimore nuk ka arritur me prova bindëse ta vërtetojë para panelit shqyrtues përgjegjshmerinë e tij në këtë aktivitet të prokurimit.

Lidhur me pretendimet ankimore të OE ankues OE "Sodex Group" SH.P.K, kundrejt OE të rekomanduar për kontratë "OE PRICOM SH.P.K & Seyntex NV", PSH do të ndalet vetëm tek pretendimet ankimore që përcaktojnë rrjedhën e vendimarrjes sa i përket ofertës së OE të rekomanduar, pa pasur nevojë që në këtë arsyetim të shtjellohet përsëri.

Duke u bazuar në kërkesat e dosjes së tenderit përkatësisht tek specifikacionet teknike të detyrueshme, PSH konstaton se, pretendimi i OE ankues ndaj OE të rekomanduar për kontratë është i bazuar për faktin se, OE i rekomanduar nuk ka dorëzuar specifikimet të cilat duhet të jenë sipas kërkesave të dosjes së tenderit, sepse kërkesë e dosjes ka qenë **"multi-hit resistance"**, ndërsa OE i rekomanduar për kontratë, nga specifikacioni -katalogu i prezantuar, shihet se ka dorëzuar **"30-06 APM2 at 878 +/- 9 m/s (1 shot)"**, nuk është dorëzuar sipas kërkesës së përcaktuar në dosjen e tenderit.

OE rekomanduar ka prezantuar nje certificate balistike per testimin me kater kaliber te ndryshem dhe njeri kalibër është rezistent për vetëm 1 shot.

Datasheet for NIJ 0101.04 Level IV ICW IIIA			
Article number:	STX4ICWAPE2924M17 / SEYNTEX MODEL VAR 59		
Standard:	NIJ 0101.04		
Level:	NIJ Level IV ICW IIIA		
Resists:	M2 AP	7.62*63mm AP	1 shot
	M61 AP	7.62*51mm AP	3 shots
	AK47 API	7.62*39mm API BZ	3 shots
	SS109	5.56*45mm	3 shots

Lidhur me pretendimet ankimore të OE ankues OE “Sodex Group” SH.P.K, kundrejt OE të rekomanduar për kontratë “OE PRICOM SH.P.K & Seyntex SV”, për të cilin pretendon se është i papërgjegjshëm për faktin se, në dosjen e tenderit tek specifikacionet teknike të detyrueshme, është kërkuar “Antiplumb i jashtëm: Outer shell from water-repellent hard wearing 1000D CORDURA fabric or equivalent, ndërsa OE i rekomanduar për kontratë nuk ka ofruar specifika për 1000D CORDURA fabric”. PSH e klasifikon të bazuar këtë pretendim ankimore.

Sipas sqarimit të dhene nga OE ankues lidhur me kete pretendim ankimor, thuhet se, OE i rekomanduar për kontratë përmes klarifikimit e ka konfirmuar qe materiali i Cordura te ofruar është 500D. Pra NUK ka ofruar produkt sipas kërkesës se DT ku është kërkuar qe Cordura te jete 1000D ose ekuivalente, prandaj 500D nuk është ekulivalente sipas kërkesës, shih me poshtë sqarimin nga interneti:

"The difference between Cordura 500D and Cordura 1000D lies in their yarn size and density. Cordura 500D has a smaller yarn size and lower density than Cordura 1000D, which means that it is thinner and lighter, but also less durable and abrasion-resistant. Cordura 1000D has a larger yarn size and higher density, making it thicker and heavier, but also more durable and abrasion-resistant. Ultimately, the choice between Cordura 500D and Cordura 1000D will depend on the specific needs of the product being made and the level of durability and abrasion resistance required."

Gjithashtu, lidhur me pretendimin ankimor se ne specifikacionet teknike është kërkuar që jeleku të jetë nga Soft Protection Level NIJIIIA (3A) – Ballistic Protection (.44 Magnum 240 / JHP). I

njëti nuk e plotëson kërkesën e lartcekur për faktin se Atestet e dorëzuara për model VAR 5 (artikulli 1) janë të performancës SJHP (Semi-Jacketed Hollow Point) dhe jo JHP (Jacketed Hollow Point) siç është kërkuar në DT. Gjithashtu edhe në katalogun e ofruar për vlerësim është potencuar SJHP. Mbrojtja e ofruar balistike për pjesën e butë balistike nuk është në përputhje me kërkesën e AK-së për mbrojtje balistike dhe si e tillë nuk i plotëson kërkesat e dosjes së tenderit dhe Specifikat teknike. Në specifikacionet teknike është kërkuar që jeleku të jetë nga Soft Protection Level NIJIIIA (3A) – Ballistic Protection (.44 Magnum 240 / JHP) AK është munduar që ta sqaroj këtë pikë duke kontaktuar me Laboratorin me email disa herë. AK me datë 27.01.2023 ka kërkuar nga laboratori klarifikim për SJHP (SemiJacketed Hollow Point) dhe JHP (Jacketed Hollow Point) por nuk ka marrë fare përgjigje nga laboratori. Një përgjigje në emër të laboratorit e ka dorëzuar vetëm OE Pricom.

AK me datë 22.02.2023 nga laboratori ka kërkuar konfirmim nëse laboratori e ka lëshuar atë përgjigje, por nuk e ka ndonjë konfirmim. Një konfirmim tjetër ka ardhur nga Seyntex (ofertues), megjithatë nga Laboratori testues nuk është pranuar as email e as konfirmim. Ndërsa kërkesa i ishte adresuar Laboratorit dhe jo ofertuesit, konsiderojmë se asnjë përgjigje nuk është pranuar nga Laboratori dhe si e tillë nuk mund të pranohet për vlerësim. PSH edhe këtë pretendim e klasifikon si të bazuar për shkak se atestet e dorëzuara janë të performancës SJHP dhe jo të JHP.

Në bazë të përshkrimeve të lartcekura, paneli duke konsideruar se OE nuk ka plotësuar plotësisht specifikat teknike të parashtruara nga AK në Dosjen e Tenderit, si dhe duke qenë se aktiviteti i prokurimit përmban natyrë të ndieshme, mbrojtjen e shëndet të zyrtarëve policorë, zgjidhja më e duhur po ashtu duke aplikuar nenin 104 të LPP ishte anulimi i tërësishëm i aktivitetit të prokurimit. Kësaj i shtohet edhe fakti se kriteret dhe specifikat teknike të hartuara në DT në raste të caktuara kanë qenë të paqarta, ku si pasojë ka lënë kuptimësi apo interpretime të ndryshme dhe rrjedhimisht kjo ka ndikuar edhe në zgjatjen e vlerësimit dhe përzgjedhjes së fituesit të kontratës. Andaj në rast të ri-tenderimit AK të ketë vëmendje të shtuar në hartimin e kriterëve të qarta pa nevojë që të ketë edhe sqarime ashtu siç e obligon edhe neni 27 i LPP.

- Përfundim -

Bazuar në të lartcekurat, Paneli konsideron se vendimi i atakuar i AK bijën ndesh me dispozitën e nenit 59 dhe 60 të LPP, pa nevojë që e njëjta të komentohet në këtë rast, meqë përbën fakt notor për çdo autoritet kontraktues. Por nga ky aspekt, Vendimi i atakuar i AK bje ndesh me qëllimin e nenit 8 (Planifikimi i Prokurimit), nenit 9 (Përcaktimi i nevojave që duhet përmbushur), nenin 22 Inicimi i aktivitetit të prokurimit. Andaj, AK në mungesë të ofertave të përgjegjshme duhet të veprojë konform dispozitave ligjore

Paneli shpjegon se secili AK (në çdo nivel) ushtron pavarësinë e tij/sajë institucionale, përfshirë dhe sektorin e prokurimit publik dhe se secili AK planifikon nevojat në harmoni me parashikimet buxhetore, mirëpo po ashtu sistemi i prokurimit publik duhet të përmirësoj në çdo aspekt kapacitetet profesionale dhe të përgatitet për proceset e integritetit sepse praktikat e mira dhe standardet e prokurimit ndërkombëtar nuk e pranojnë që vlerësimi i ofertave të bëhet në kundërshtim me kërkesat dhe specifikat e përcaktuara në Dosjen e Tenderit. Andaj Paneli konsideron se mori vendimin e duhur dhe konsideron se procesi i anulimit të këtij aktiviteti të

prokurimit ishte zgjidhja me e drejtë dhe e duhur (pa paragjykim të vendimit të AK).

Andaj nga të lartcekurat, paneli shqyrtues ne pajtim me nenin 117 të LPP, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.



Kryetar i Panelit Shqyrtues

Vedat Poterqoi

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - POLICIA E KOSOVËS**
- **OE - Sodex Group SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: